

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Per punime per rinovimin e ambientit per instalimin e skanerit tip CT model “Philips/Ingenuity Flex 32 ose ekuivalent ne Spitalin Kavaje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): “Punime ndertimi”

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,346,409 (shtate milion e treqind e dyzete e gjashte mije e katerqind e nente leke) pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Kavajë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

- Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit të kërkuara në Kreun I të Shtojcës 7;
- Deklaratën për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut të realizimit të objektit të kontratës;
- Deklaratën për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate;
- Deklaratën për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate;
- Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera, si dhe çdo të dhënë dhe informacion tjetër të nevojshëm të përcaktuar në përmbajtjen e Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 8).

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, si dhe nenet 25-26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

Në bazë të nenit 76 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 25 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kriteret e përgjithshme të kualifikimit janë të detyrueshme për t’u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, në funksion të rritjes së përgjegjshmërisë së operatorëve ekonomikë për të zbatuar legjislacionin shqiptar në fuqi apo legjislacionin e shtetit të origjinës.

Sqarojmë se, ndryshimet ligjore kanë një qasje të re në fushën e prokurimit publik, duke lehtësuar konkurrimin e operatorëve ekonomikë me anë të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit, që përmban informacion dhe deklarime shumë të rëndësishme për përmbushjen e detyrimeve ligjore, të pasqyruara në mënyrë të qartë në pikën 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Deklarata të tilla lidhen me ushtrimin e aktivitetit të ofertuesve në bazë të ligjit, shmangien e konfliktit të interesit, korrektësinë e ofertuesve për të paguar taksat dhe detyrimet ndaj shtetit, përmbushjen e përgjegjësisë në fushën e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës, pengimin e marrëveshjeve ndërmjet operatorëve ekonomikë që çenojnë konkurrencën në treg, plotësimin e specifikimeve teknike, grafikut të zbatimit të kontratës, si dhe përmbushjen e kërkesave teknike profesionale për stafin dhe pajisjet teknike, në funksion të përmbushjes së kontratës në mënyrë cilësore.

Ndërkohë, legjislacioni i prokurimit publik ka rritur përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktor për të kontrolluar dhe verifikuar vërtetësinë e deklaratave të operatorëve ekonomikë. Përkatësisht, në bazë të pikës 2 të nenit 82 të LPP dhe pikës 7 të nenit 26 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për deklaratat. Për këtë qëllim, në pikën 3 të nenit 26 është përcaktuar detyrimi i operatorëve ekonomikë, që informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, për të cilin ekziston një bazë të dhënash, duhet të shoqërohet me adresën/referencën përkatëse, në mënyrë që AK të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin konkret. Në çdo rast, në zbatim të paragrafit të parë të nenit 26/6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari sipas radhës, duhet të dorëzojë pranë institucionit dokumentacionin shkresor provues, të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit të sipërcituar, , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose kopje të njësuar me origjinalin.

Ndërsa në rastin e ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, është e mjaftueshme që oferta e tyre e dorëzuar në sistemin elektronik të shoqërohet me një

marrëveshje bashkëpunimi ku të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Por, AK para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, iu kërkon grupit të operatorëve ekonomikë, të cilët kanë rezultuar fitues, të dorëzojnë:

- a. Marrëveshje të noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;*
- b. Prokurë të posaçme të noterizuar.*
- c. Vërtetimet e pasqyruara apo dokumentacionin mbi vetëdeklarimet e kërkuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese, të dorëzuara në sistemin elektronik.*

Këto kërkesa të Autoritetit Kontraktor mbështeten tek neni 14 i ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe tek neni 26/6 dhe neni 88 i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Lidhur me mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera, një risi e legjislacionit të prokurimit publik, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar tek dokumentet e tenderit një sqarim për referencat ligjore ku duhet të mbështeten operatorët ekonomikë në raste të tilla, konkretisht:

Në rast se operatori ekonomik konkurrues mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të zbatohen me korrektësi dispozitat ligjore të parashikuara në nenin 84 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 90 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Lidhur me përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme të kualifikimit, shtojcës 7 dhe shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 (pika 1/a dhe 2) dhe nenin 82 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 26 dhe nenin 39 (pika 6/b) të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, në nenin 40 (pika 1) të ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2019, 2020 dhe 2021) ku vlera e tyre te jete jo me vogël se **40% e vlerës së fondit limit* (2 938 564 leke pa tvsh) për të cilat konkurron operatori.**

Nëse operatorët ekonomikë, që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, bazuar në nenin 49 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 11 dhe nenin 55 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sepse vlera e përlllogaritur e këtij investimi është nën kufirin e ulët monetar.

Konkretisht, fondi limit i kontratës prej është nën kufirin e ulët monetar, bazuar në nenin 33 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 11, pika 1/b, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Për rrjedhojë, përcaktimi i përqindjes së kërkuar, ku vlera minimale e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, bazohet në nenin 55 (pika 4) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku citohet: “Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm./ Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.” Madje, në dokumentet e tenderit është përcaktuar qartë se mjafton që vlera e kërkuar e xhiros vjetore të arrihet në një nga tre vitet e fundit, në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në funksion të rritjes së konkurrencës. Bazuar në interpretimin e dispozitave e mësipërme, Autoriteti Kontraktor ka synuar të përcaktojë kritere të thjeshta pranimit, jo vetëm në aspektin ekonomik financiar, por në tërësi për të gjitha kriteret tekniko profesionale, në mënyrë që të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes në këtë procedurë të biznesit të vogël dhe të mesëm, çka përbën edhe përmbajtjen substanciale të procedurës së thjeshtuar. Është kjo arsyeja që nuk është kërkuar fare paraqitja e bilanceve vjetore dhe siç do të shihet në vijim janë reduktuar edhe një sërë kriteresh teknike profesionale, gjithmonë duke gjetur një baraspeshë mes synimit për të zgjeruar konkurrencën, pa prekur cilësinë e zbatimit të kontratës.

Bazuar në nenin 5, shkronja “dh” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 5 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, kohëzgjatja e periudhës raportuese apo periudha tatimore është e njëjtë me vitin kalendarik prej 12 muajsh, që fillon në datën 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Ndërsa përcaktimi i tre viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, mbështetur në nenin 43, pika 1 & 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është një kriter që zgjeron mundësinë e konkurrimit të operatorëve ekonomikë, pasi mjafton që vlera e xhiros minimale të përmbushet në një vit të vetëm të periudhës 3-vjeçare të kërkuar nga AK.

2.2.2Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2022 (tarifat e plota apo këstet që ka shlyer për 2022 sipas afateve të njëjësive përkatëse të qeverisjes vendore), sipas vendodhjes të ushtrimit të aktivitetit të përcaktuar në Ekstraktin e Rregjistrimit Tregtar,

bazuar në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të njësive vendore përkatëse të miratuara për këtë qëllim. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter duhet të plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi (shtojca 8). Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari sipas renditjes, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK-së të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi Seksionit 2.2.2: Për të ndërgjegjësuar operatorët ekonomikë për detyrimin e tyre për të paguar taksat lokale është kërkuar "Vërtetim nga Njësia Vendore pranë të cilës është rregjistruar operatori ekonomik për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2022" (tarifat e plota apo këstet që ka shlyer për 2022 sipas afateve të njësive përkatëse të qeverisjes vendore) në bashkinë/bashkitë përkatëse, sipas vendodhjes të ushtrimit të aktivitetit të përcaktuar në Ekstraktin e Rregjistrimit Tregtar, në zbatim të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, gërma "c" ku citohet se organi i qeverisjes vendore (këshilli): "...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale". Bazuar në ligjin e sipërcituar, operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Lidhur me plotësimin e këtij kriteri tek dokumentet e tenderit janë sqaruar operatorët ekonomikë se: "Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2022 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi (shtojca 8). Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari sipas renditjes, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK-së të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin." Një sqarim i tillë është dhënë herë pas here, në funksion të qartësisë së operatoreve ekonomikë lidhur me ndryshimet e fundit ligjore, bazuar në paragrafin e parë, të pikës 6, të nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

Punë të ngjashme, për 1 (një) objekt të vetëm në vlerën jo më të ulët se 30% e vlerës së përlloratur të kontratës, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Punë të ngjashme ku vlera totale e punëve të kryera gjatë pesë viteve të fundit, të marra së bashku është të paktën sa vlera limit e kësaj kontrate.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat dhe dokumentat e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të vërtetohet cilësinë e kryerjes së punimeve dhe që kontrata është realizuar me sukses.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore;
- Aktin e marrjes në dorëzim;
- Dhe çdo lloj dokumenti tjetër që provon realizimin me sukses të punëve;

Në rastet se kontratat e ngjashme, janë realizuar si Bashkim Operatorësh apo me nënkontraktorë, operatori ekonomik ofertues në fazën e ofertimit në sistem, mjafton të paraqesë:

→ Formular vlerësimi (ku përfshihen të dhënat lidhur me përqindjen e pjesëmarrjes).

Në të tilla raste, kur operatori ekonomik/subjekti renditet i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë në bazë të kërkesës së AK-së të gjithë dokumentacionin provues të deklaruar tek formulari i vlerësimit (origjinal ose të noterizuar), si dhe dokumentacionin, si më poshtë;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë marrëveshjen e nënkontraktimit, preventivin e ndarjes së punimeve, miratimin zyrtar si nënkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor, si dhe çdo dokument tjetër që vërteton punët e kryera sipas marrëveshjes së palëve.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39 (pika 4) dhe nenin 55 (pika 4, shkronja "a") të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Konkretisht në procedurat e hapura të thjeshtuara, për plotësimin e përvojave të ngjashme, në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", përkatësisht në nenin 55, pika 4, shkronja "a", paragrafi "i" & "ii", citohet:

- i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit¹ që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Gjithashtu, në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39, pika 4, citohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar qartë dokumentet që kërkohen për përmbushjen e këtij kriteri, referuar dispozitave të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” i ndryshuar dhe të VKM-së Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar. Dokumente të tilla në tërësinë e tyre vërtetojnë kryerjen e punëve të ngjashme sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

Lidhur me dokumentet që janë kërkuar nga AK, në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe të nënkontraktorëve, AK ka sqaruar se gjatë fazës së ofertimit në sistem mjafton formulari i vlerësimit. Ndërkohë dokumentet e tjera të tenderit (origjinal ose të noterizuar) duhet të dorëzohen vetëm nga operatori ekonomik (ose BOE), që do të rezultojë fitues, para publikimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, bazuar në paragrafin e parë, të pikës 6, të nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ndërkohë, si në të gjitha rastet e tjera, nëse gjykohet e arsyeshme nga KVO gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, ka të drejtë të kërkojë çdo informacion dhe dokument të nevojshëm për të vërtetuar deklaratimet e pasqyruara në formularin e vlerësimit, në bazë bazë të pikës 2 të nenit 82 të LPP dhe pikës 7 të nenit 26 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në raste të tilla, dokumentet që vërtetojnë kryerjen e punëve të ngjashme duhet të shoqërohen edhe me dokumentet, që ligjërojnë bashkimin apo nënkontraktimin, si dhe me preventivin e ndarjes së punimeve. Një kërkesë e tillë, bazohet në nenin 14 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 88 dhe nenin 89, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Sqarojmë se kontratat e ngjashme, janë një nga kriteret themelore për të provuar jo vetëm eksperiencën e operatorëve ekonomike, por edhe përgjegjshmërinë profesionale në kryerjen e investimeve në mënyrë cilësore.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **NP-2 A** “Punime gjurmimi në tokë”;
- **NP-3 A** “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”;

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **NS-2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **NS-4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- **N.S- 12 A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

Ofertuesi duhet të bëjë njehsimin e licencave profesionale të lëshuara nga vendi i origjinës për kategoritë e punimeve të kërkuara për realizimin e kësaj kontrate, pranë institucionit përkatës kompetent në Republikën e Shqipërisë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, licencat profesionale duhet t’i paraqesin të dy operatorët ekonomikë, të cilët duhet të kenë kategoritë përkatëse që lidhen me punimet që kanë marrë përsipër të kryejnë.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nenin 39, pika 6/a, të. Një kriter i tillë bazohet edhe në nenin 8 (paragrafi 1) të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ku citohet: “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore”. Rregullat e detajuara për përcaktimin e licencave të shoqërive në fushën e ndërtimit përcaktohen edhe në një sërë aktesh nënligjore, konkretisht në VKM Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, si dhe në VKM-në nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar.*

Meqenëse konkurrenca është e lirë për të gjithë operatorët ekonomikë duke përfshirë dhe të huajt, në kushtet kur aktiviteti i tyre apo sipërmarrja e tyre ka ndikim në tregun e brendshëm, në zbatim të ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar. Komisioni ka parashikuar mundësinë e shprehjes së interesit për të marrë pjesë në tender edhe të operatorëve ekonomikë të huaj. Në raste të tilla është kërkuar që të zbatohet procedura ligjore për njehsimin e licencave profesionale pranë institucioneve kompetente shqiptare, në

zbatim të Kreut III, pika 3 të VKM-së Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Niveli i klasifikimit të shoqërisë është përcaktuar nga specialisti i fushës së ndërtimit, në zbatim të Kreut V të të VKM-së Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar .

Duke analizuar zërat e punimeve, si dhe tërësinë e dokumentacionit teknik të projektit të kësaj kontrate, janë përcaktuar kategoritë e punimeve që kërkohet të ketë liçenca profesionale e shoqërive konkurruese. Në funksion të qartësisë të kandidatëve konkurruesë, më poshtë në përmbajtjen e këtij procesverbali janë përcaktuar përshkrimet e detajuaara/shpjegimet për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme dhe speciale, në zbatim të të VKM-së nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar dhe VKM-së Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar .

Kërkesat janë përcaktuar në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës, duke iu referuar preventivit dhe projektit në tërësi, në zbatim të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit t punimeve (punime arkitektonike dhe strukturore). Bashkelidhur DST.

2.3.3.(a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, jo më pak, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (nje)

Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë, ku të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e ndërtimit. Ndërkohë, drejtuesi teknik duhet të ketë kontratë pune të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë jo më pak se tre muaj e fundit. (*Kjo deklaratë përfshihet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, përkatësisht tek Shtojca 8, Pjesa III/D “Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera”.*) Ndërkohë, si për çdo deklaram tjetër, operatori ekonomik i renditur i pari, me kërkesë të AK-së duhet të dorëzojë para publikimit të njoftimit të fituesit, dokumentacionin vërtetues ligjor (origjinal ose të noterizuar),

Argumentimi për pikën 4 Seksioni 2.3 i KVK: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020

“Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Bazuar në parashikimet e legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës, NP - 2, NP – 3, NS - 4, NS - 12 eshte e nevojshme prezenca e specialisteve te sipercituar.

2.3.3. (b) Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë të paktën një punonjes pergjegjes të shoqërisë që të disponojë dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë nje (1) punonjes pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune , I cili te jete I certifikuar “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen ne pune”ne perputhje me klauzolat e ligjit nr 10327 date 18.02.2010”Per sigurine dhe shendetin ne pune “dhe VKM NR 312 DATE 05.05.2010”Per Miratimin e Rregullores per Sigurine ne Kantjer”.“Për sigurinë në kantier”. Për punonjesin pergjegjes duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim: Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë 1) punonjes pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune , I cili te jete I certifikuar “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen ne pune”ne perputhje me klauzolat e ligjit nr 10327 date 18.02.2010”Per sigurine dhe shendetin ne pune “dhe VKM NR 312 DATE 05.05.2010”Per Miratimin e Rregullores per Sigurine ne Kantjer”.“Për sigurinë në kantier”. Për punonjesin pergjegjes duhet të paraqitet certifikata

e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizëm i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.

2.3.3(c) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit, personelin kryesor dhe punonjesit specialistë të kualifikuar, të vërtetuar me dëshmi kualifikimi profesionale, certifikata ose diploma ose certifikata të shkollës profesionale përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licensuara nga organet përkatëse kontrate pune individuale, jo më pak si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Hidraulikë 1 (nje)
- Elektracistë 2 (dy)
- Saldator 1 (nje)
- Teknik kondicionimi 2 (dy)
- Karpentier (murator) 2 (dy)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Nuk do te njihen si deshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjekte të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Argumentimi: (: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe V.K.M -së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/c dhe 6/ç si dhe nenin 26 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku thuhet “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”),

2.3.3.(d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore mesatarisht 5 punonjës me kohë të plotë per tre muajt e fundit. Mesatarisht 15 punonjes gjithesej duke perfshire specialistë e kualifikuar mesiper sipas kriterit 2.3.3 C. Për këtë operatorët ekonomik duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për tre muajt fundit, ku te figurojne te gjithe punonjesit qe do te perfshihen ne kete kontate.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv. Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në bazë të volumeve dhe grafikut të punimeve, tipologjia e objektit të kontratës. Theksojmë se ky kriter nuk është vendosur për të cënuar përcaktimet e nenit 3 të LPP Nr. 162/2020, për të mos garantuar trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën, por për të realizuar kontratën brenda afateve dhe me cilësi. Kërkesa e mësipërme mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej mesatarisht 15 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.3.(e) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar dhe të jene në listpagesën e shoqërisë si më poshtë:

Minimumi 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikate konformiteti si **“Ekspert në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese”**, të lëshuar nga komisioni i mbrojtjes nga rrezatimi.

Për përmbushjen e këtyre kriteve, operatori duhet të paraqesë diplomë/ Certifikatat e cituara më sipër, kontrate pune dhe të figurojnë ne listepagesat e shoqerise minimumi tre muajt e fundit.

2.3.3.(f) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin e punimeve i cili duhet të jete Inxhinier ndertimi me experience pune, i cili duhet të jetë i perfshire ne licencen e shoqerise dhe të deklaroje se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtëm: diplome/license, libreze pune dhe kontrate pune.

Argumentimi: Argumentimi për pikën 2.3.3. e dhe f Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për Ekspertin ne fushen e mbrojtjes nga rezatimi jonizues është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Kriteri për stafin drejtues, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për ekspert specifik në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton (njera te jete veteshkarkuese)	2 copë	Në pronësi ose me qera
2	Matrapik per prishjen e punimeve te betonit	2 copë	Në pronësi ose me qera
3	Kokore	15 copë	Në pronësi ose me qera
4	Gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Saldatrice	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Trapan	2 copë	Në pronësi ose me qera
8	Fresibel	2 cope	Në pronësi ose me qera
9	Aparat mates i rrymes elektrike	1 cope	Në pronësi ose me qera

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

a) dokumenti që vërteton pronësinë (certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);

b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik ;
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

- Kur janë me qera, duhet të paraqitet :
 - a) kontrata e qirasë me afat brenda perfundimit të punimeve
 - b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik ;
 - d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, nuk do të jenë të angazhuara në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër, por vetëm për realizimin e këtij objekti. (Kjo deklaratë përfshihet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, përkatësisht tek Shtojca 8, Pjesa III/D “Deklaratë mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera”.)

Ritheksojmë se, disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit.

Ndërkohë, për të gjitha deklaratet e operatorit ekonomik të pasqyruara në shtojcën 8, AK gjatë procesit të shqyrtimit të ofertave ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme ***mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.***

Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST-së. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve, si dhe të gjitha dokumenteve të tjera të kërkuara nga AK, do të jetë kusht për moskualifikim/refuzim.

Argumentimi pika 2.3.4: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (Shtojca 8). Për rrjedhojë, si për shumicën e kriterëve të përcaktuara nga AK, ”përmbajtja e dëshmimeve/të dhënave që vërtetojnë nëse mjetet dhe pajisjet teknike janë në pronësi ose me qira duhet të pasqyrohen në

seksione të ndara sipas përmbajtjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, përkatësisht tek Shtojca 8, Pjesa III/C “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 82 të LPP dhe nenin 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Ndërkohë, për të gjitha deklaratimet e operatorit ekonomik të pasqyruara në shtojcën 8, AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, bazuar në pikën 7 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialisti i fushës së ndërtimit. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” i ndryshuar. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Duke marrë parasysh se mbrotja e jetës dhe shëndetit të punonjësve është parësore, AK ka kërkuar mjete dhe pajisje mbrojtëse, në bazë të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, VKM-së Nr.564, datë 3.7.2013 Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës” e ndryshuar. Për rrjedhojë, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me mjete dhe pajisje teknike mbrojtëse në punë për punëtorët dhe personelin.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë dhe të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Çertifikatë ISO 9001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Çertifikatë ISO 45001: 2018** mbi “**Shëndeti dhe Siguria në punë**” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;

Certifikatat si më sipër duhet të jene të akredituara dhe të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi 2.3.5: Në bazë të nenit 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, ka kërkuar nga ofertuesit të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, të cilat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Për përcaktimin e çertifikatave të cilësisë, referuar natyrës dhe llojit të kontratës, Autoriteti Kontraktor është bazuar në ligjin nr.9870, datë 4.2.2008 “Për standartizimin” i ndryshuar, duke iu referuar Katalogut të Standarteve Shqiptare i fundit të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimeve. Ndërkohë, AK ka sqaruar se për çdo rast, në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikata ISO të vlefshme sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes.

Në zbatim të nenit 5 të ligjit Nr.9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin” i ndryshuar, qëllimi i veprimtarisë së standardizimit është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, si dhe mjedisin, duke ndihmuar në zbatimin e legjislacionit, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë e shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar, në këtë mënyrë, rregulla të përbashkëta; të promovojë cilësinë dhe efektshmërinë e produkteve, të proceseve dhe të shërbimeve, si dhe të kontrolleve të ndryshme, duke siguruar përputhshmërinë, si dhe përdorimin me efektivitet të tyre.

Pavarësisht se në përcaktimin e çertifikatave jemi bazuar në Katalogun e Standarteve Shqiptare të fundit të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimeve, pranohen edhe certifikata cilësie ekuivalente apo të barasvlefshme me ato të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të nenit 44, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Në raste të tilla, nëse është e nevojshme nga KVO mund të kërkohej edhe ndihma e Drejtorisë së Përgjithshme së Standarteve për të verifikuar nëse ato janë ekuivalente me ato të përcaktuara nga AK.

2.3.6 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë planin e organizimit të kantierit, metodologjinë punimesh si dhe analizat e cmimit për të gjitha zerrat e preventivit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm;

Autorizim nga prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për pajisjet si;

- Paisje Kondicionimi
- Xham të Plumbuar me mbrojtje nga rezatimi
- Material Plumbi (Pb) (për mbrojtje nga rezatimi)
- Shtrese Vinil (PVC)

Së bashku me autorizimin operatori ekonomik do të paraqesë dhe kataloget përkatëse me specifikimet teknike për materialet e mesiperme.

Argumentimi 2.3.7: Në bazë të nenit 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, , ka kërkuar autorizim nga prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për pajisjet e sipercituara të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, të cilat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë të nënshkruara dhe volusura në çdo faqe. Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklaratat apo dokumentet e dorëzuara në sistem nga konkurruesit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme duhet të deklarohet në shtojcën nr. 8, sipas V.K.M -së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”. Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkoj garanci dhe cilësi për produktet/materialet lidhur me punimet që do të kryhen në objekt.

Ky procesverbal përmban 17 faqe, hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet në çdo faqe nga struktura e posacme e ngritur me urdhrin nr. 279/1 date 07.03.2023.

Ky procesverbal i jepet njesise se prokurimit per DST për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim .

Komisioni:

Anetar	Anetar	Kryetar	Anetar	Anetar
Bashkim Derjaj	Agron Beu	Mimoza Vogli	Dritan Karkini	Dorian Muzhaqi